



**Vox**  
**Baroque**


Festivali i muzikës së vjetër  
*Edicioni i 3<sup>të</sup>*  
3 -11 korrik 2016

**JUSUF BESHIRI** / DREJTUES I FESTIVALIT

PROGRAMI



## SPONSORËT



BASHKIA TIRANË



BASHKIA KORÇË



BASHKIA VLORË



# Festivali i Muzikës së Vjetër

## “Vox Baroque”

(2 deri më 11 korrik, 2016)

Festivali i Muzikës së vjetër “Vox Baroque mbetet aktiviteti i vetëm në llojin e tij në Shqipëri. Ky festival i kushtohet tërësisht repertorit barok. Përhapja e kësaj muzike të luajtur me instrumente origjinale, në respekt të plotë të stilit, rregullave dhe mënyrës së interpretimit të asaj kohe, shikimi i muzikës me një këndvështrim tjetër historik dhe kritik duke kërkuar gjithmonë qasje të reja, formësojnë idealin tonë për të zhvilluar këtë festival të përvitshëm.

Të vetëdijshëm në kurimin e detajeve e repertorit të mirë përzgjedhur, dëshirojmë të kërkojmë më thellë në muzikë drejt rrugës së perfeksionimit të vazhdueshëm, në kërkim të emocioneve dhe esencës të së bukurës. Repertori barok ende sot ofron shumë hapësira për zbulime e thellime, të cilat do të manifestohen nga interpretuesit midis të tjerash mes shëmbujve të gjuhës e gjestualitetit barok. Interpretimi përmes një “assieme” të gjesteve ekspresive të cilat përdorshin nga këngëtarët për të nënvizuar emocionet në tekstet e kantatave, do të na afrojë drejt atmosferës të skenave operistike.

Hapja këtë vit e festivalit do të zhvillohet në qytetin e Korçës në një nga oborret e Pazarit të Vjetër, së fundmi i restauruar. Kryeqyteti do të presë muzikantët në hapësirën e Hotel Dajtit duke u pasur në ditët në vijim me një koncert- leksion i cili do të mbahet në Universitetin e Arteve mes studentëve e pedagogëve për të afruar kështu akoma më tepër këta të fundit me tingujt e muzikës baroke përmes shpjegimit të stilit dhe veçorive specifike që ajo mbart. Petrolifera Italo-Shqiptare e Vlorës do të jetë shtëpia e muzikës për një prej koncerteve të këtij festivali ku Albanian Baroque Ensemble do të performojë sëbashku me dy të ftuar special, emra të spikatur në arenën ndërkombëtare. Kisha e Shën Thanasit e sapo restauruar në skajet e Lagunës së Karavastasë përbën destinacionin me karakter disi ekzotik të këtij rrugëtimi muzikor; duke përcjellë artin e duke zbuluar vlerat e trashëgimisë kulturore vendase. Asesi nuk mund të linim pa i dedikuar një mbrëmje artistike të denjë, qytetit të Beratit, ku do të finalizohet cikli 10-ditor i festivalit. Ky koncert do të mbahet në hapësirat e Muzeut Onufri.

Bashkëpunimet artistike që Festivali Vox Baroque do të sjellë këtë vit i kalojnë kufijtë e kontinentit evropian duke mbërritur deri në ato aziatik. Një itinerar muzikor dhe turistik për të gjithë ata që dëshirojnë të shijojnë tingujt e kësaj muzike së bashku me bukuritë e vendeve ku kjo do të luhet, duke promovuar dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të vendit tonë.

*Jusuf Beshiri*

*Themelues i Festivalit “Vox Baroque”*

# Kalendari i Programit

DATA	QYTETI	VENDI	ORA	GRUPI PERFORMUES
3 Korrik 2016	Korçë	Pazari i Vjetër i Korçës, Hani i Elbasanit	20:00	I Pizzicanti
4 Korrik 2016	Tiranë	Hotel Dajti	20:00	I Pizzicanti
6 Korrik 2016	Tiranë	Koncert-leksion me studentë të universiteteve, pranë instalacionit "Reja" e Fujimoto-s	20:30	Albanian Baroque Ensemble
7 Korrik 2016	Tiranë	Hotel Dajti	20:00	Albanian Baroque Ensemble
9 Korrik 2016	Vlorë	La Petrolifera Italo Albanese	20:00	Albanian Baroque Ensemble
10 Korrik 2016	Karavasta	Kisha e Shën Thanasit	11:00	Laboratorio Armonico
11 Korrik 2016	Berat	Muzeu Kombëtar Onufri	19:30	Laboratorio Armonico

*Shkëputur nga netët e edicionit të kaluar.*



# “Mélange Barocco”

## I PIZZICANTI

Francesco Spendolini  
*Chalumeaux*

Katia Viel  
*Violino*

Mathilde Legrand  
*Mezzo Soprano*

Eloy Orzaiz Galarza  
*Clavicembalo*



Shpesh muzika baroke i atashohet formave të tjera të artit: poezisë, për efektin e përsosur që krijohet nga bashkimi i tyre në saj të inspirimit që njëra merr nga tjetra.

Por mes shumë formash të tjera të artit, piktura është ajo që shpesh shpreh më mirë realitetin e mijra hijeve dhe ndjenjave të provokuara nga tingujt muzikorë.

Tingujt si ngjyrë dhe instrumentet si një paletë që në duart e kompozitorit që di të japë formë dhe « sensación » materies të pakapshme nga muzika. Sigurisht që tingulli më i dëshiruar dhe imituar ka qënë ai njerëzor, burim inspirimi dhe stimuli i vazhduar për kompozitorë dhe instrumentistë. Kështu përmes këtij « Mélange Barocco », propozohet një ri-interpretim i ngjyrave të muzikës të fillim shtatëqindës, përmes zërit, të shoqëruar nga violina, ngjyrim primar i imitimit të tingullit njerëzor, klavijembalo dhe një instrument i ri që do ti paraprinte klarinetës moderne, chalumeau. Një sfumature e re timbrike, here me doza melankolie here baritore, vjen kështu e prezantuar në paletën baroke nga kompozitorë të rëndësishëm si Telemann, Vivaldi mbi të cilët kompozitorë të tjerë pasardhës kanë dashur të ekperimentojnë.



# Programmi:

---

**Johann Friedrich Fasch (1688-1758) FaWV**

**Koncert per Chalumeau in Sib maxhor L :BI 10' minuta**

- Largo
- Un poco allegro
- Largo
- Allegro

**Francesco Bartolomeo Conti (1681-1732)**

**Cantata e Tretë « Con più luci di candore », per Vokal, Chalumeau, Violinë, e BC 10' minuta**

- Aria
- Recitativo
- Adagio
- Recitativo
- Aria

**Georg Philipp Telemann (1681-1767)**

**Weicht ihr Sünden aus der « Harmonisches Gottes-dienst »**

**Kantate zum Achten Sonntag nach Trinitatis 11' minuta**

- Vivace
- Recitativo
- Aria

**Georg Philipp Telemann (1681-1767)**

**Trio Sonata n. 3 në Sol minor, nga Esercizii Musicali 10' minuta**

- Mesto
- Allegro
- Largo/Andante/Largo
- Vivace

**Antonio Caldara (1679-1736)**

**Aria « In quel giorno sventurato » nga oratorio « il Rè del dolore » 6' minuta**

**Antonio Vivaldi (1678-1741)**

**Sonata për violinë n.3 në Re minor, 12 Sonatat për Violinë e B.c. Op. 8' minuta**

- Preludio, Andante
- Corrente, Allegro
- Adagio
- Giga, Allegro

**Georg Friederich Haendel (1685-1759)**

**Aria « Dopo notte atra e funesta » aus Ariodante 7' minuta**

**\* Bis eventual jashtë programi**

**Conti « Vola Presto » 6' minuta**

# “Si Dolce tormento”

## ALBANIAN BAROQUE ENSEMBLE

Miho Kamiya (e ftuar)  
*Soprano*


Daorsa Dervishi  
*Flauto traversiere*

Klodiana Babo  
*Violino barocco*

Perikli Pite  
*Cello & viola da gamba*

Giangiaco Pinardi (i ftuar)  
*Tiorba*

Jusuf Beshiri  
*Cembalo*



Udhëtimi muzikor i Albanian Baroque Ensemble hap koncertin me Fuggi Fuggi Fuggi da questo cielo ( ballo di mantova), një nga pjesët më të njohura në panoramën muzikore e përhapur në gjithë botën pas vitit 1650. Ushtarët ballkanike e mësuar këtë këngë gjatë rrethimit 22 vjeçar të Kretës dhe më pas e përhapën kudo në zonat ballkanike dhe ato të mesdhit. Kjo melodi me kalimin e kohës është modifikuar dhe ka frymëzuar muzikantë si B.Marini që me sonatën “Fuggi dolente core”, ka realizuar një kryevepër me ndërthurjen e zërave, duke ekzaltuar shijen dhe guston e periudhës më të lavdishme të barokut italian.

Një zbulim i papritshëm duke kërkuar në disa libra antike të 1600 në momentin që po programoja repertorin e koncerteve të këtij viti i jep titullin koncertit. Si dolce tormento ose Amor Costante e Carlo Milanuzzi-t, teksti i të cilit është zgjedhur nga Claudio Monteverdi për të krijuar mes hijesh, një nga më të famshmet arie-kanonet e historisë së muzikës botërore duke i rezistuar çdo lloj stili që nga 1600 deri në ditët e sotshme. Prezantimi i aries të Milanuzzi-t është një perlë në festivalin tonë sepse



---

është hera e parë pas 400 vjetësh që kjo arie del nga faqet e librit, dhe interpretohet së bashku me atë të Monteverdit.

Më pas programi ka një ndryshim ngjyre dhe gjuhe muzikore, shumë e evidentuar me autorët e periudhës së shtatëqindës. Janë këta autorë që udhëhiqnin botën muzikore në qendrat muzikore të epokës. Për Giuseppe B. Sammartini i njohur si muzikant menjëherë pas arritjes në Londër e dëshmon në mënyrë shumë gjallërore Charles Burney në librin e tij "*Viaggio musicale in Italia*" ku tregohet takimi me vëllain e muzikantit, që gjithmonë Burney e përshkruan muzikën e tij "mbushur me shkencë (njohuri), originalitet dhe zjarr.

Aria e tortorellë-s një metaforë shumë e njohur në repertorin e 700-ës është përdorur nga të gjithë autorët, dhe Scarlatti që nuk ishte indiferent i kësaj ka krijuar një kryevepër brenda kantatës "Bella Madre dei Fiori". A. Scarlatti (i lindur në vitin e artë 1685 së bashku me Bach dhe Haendel i njohur për sensibilitetin e tij në repertorin vokal,) bën pjesë në bouchet e autorëve që kantabiliteti i linjës muzikore i përputhet një sensibilitet shpirtëror i thellë.

Zhanri i kantatës shumë i kërkuar nga publiku dhe muzikantët shërbente gjatë gjithë periudhës së vitit jo vetëm në periudhat e festave fetare por edhe në evente profane. Kjo veçanti ishte shumë e preferuar edhe nga Antonio Vivaldi i cili për efekte të ndryshme zgjidhte mënyrën e orkestrimit me instrumente të shumëllojshme, për të evidentuar turbullimet e vuajtjes të dashurisë.

Në 1711 M. Marais publikoi librin e tretë të "Pièces de viole", dhe pjesa Grand Ballet evokon ornamente e zbulurime të mbingarkuara dhe kontraste të vazhdueshme në refrenet dhe në variacione të pafundme.

Një nga titujt më të rëndësishëm të zhanrit lirik francez *tragédie lyrique*, është opera Scanderbeg e François Rebel e François Francoeur me libretin e A. H. de La Motte e kompozuar në Francë, në një shoqëri ku shija për heronjtë dhe ekzotikun ishte shumë e rrënjëzuar. Kjo opera e pasur me efekte skenike, vallzime, arie dhe marshe u shfaq për herë të parë në 27 tetor 1735 në "Académie Royale de Musique" dhe e publikuar në të njëjtin vit. Duke pasur shume sukses u ripunua dhe u shfaq sërish në 22 tetor 1763 në praninë e mbretit.

Kjo vepër është e shquar si një nga operat turke më të përpunuara, me detaje skenografike të xhamive dhe të oborreve dhe me shumë personazhe ekzotik. Duke pasur shumë sukses kjo opera u paraqit sërish në Fontainebleau, 22 tetor 1763 përpara oborrit mbretëror.

Në shtator të 1737 Telemann u largua për një udhëtim në Paris, dhe në përgatitje të kësaj lëvizjeje kompozoi në 1730 një seri me 6 Kuartete me titullin "*Quadri a violino, flauto traversiere, viola da gamba o violoncello, e fondamento*". Ndërkaq me arritjen në

---

Francë publikoi një seri tjetër me 6 kuartete. Të gjithë 12 kuartetet të ashtuquajtura Kuartetet e Parisit u luajtën gjatë qëndrimit në këtë qytet dhe patën shumë sukses, duke u luajtur nga virtuozët më të njohur të kohës, gjë që në pak kohë i rritën famën botërore kompozitorit gjerman. Kuarteti i parë në sol maxhior është i mbushur me ndjenja, elegancë, ngrohtësi, hov, inteligjencë, ngjyra të jashtëzakonëshme dhe ritme energjike. Këto karakteristika e vendosin në kreshtën e artë të veprave të muzikës së dhomës në epokën e barokut të vonshëm.

*Perikli Pite*



# Programmi:

---

**Giuseppino Del Biado** (1550 - 1616)

Fuggi Fuggi Fuggi da questo cielo 3' minuta

**Biagio Marini** (1587-1643)

Sonata a tre sopra "Fuggi dolente core" da Sonate da Chiesa... Libro terzo.

Venezia, 1655 2.45 min

**Johannes Jeronimus Kapsberger** (1685-1759): Sonata for two violins, op.5 Nr 2

Toccata 3 min

**Carlo Milanuzzi** (fine del XVI sec - 1647)

Dal Primo scherzo delle ariose vaghezze (1622)

Amor Costante (Si dolce è 'l tormento) 3 min

**Giuseppe Baldassare Sammartini** (1695 - 1750)

Adagio

Allegro

Largo

Allegro (10 min)

**Alessandro Scarlatti** (1660 - 1725)

Nga "Bella Madre dei fiori" cantata per soprano, archi e basso continuo Sinfonia

"Tortorella dai flebili accenti" (aria) 9 min

**Antonio Vivaldi** (1678 - 1741)

Mentiti contenti son veri tormenti, nga "All'ombra di sospetto" cantata per traversiere, soprano e continuo RV687 4 min

**Georg Philipp Telemann** (1681 - 1767)

Suite nr° I dai Quartetti Parigini

Grave-Allegro- Grave-Allegro

Largo-Presto-Largo

Allegro 10 min

**Marin Marais**

Pièce de Viole troisième Livre 1711

Grand Ballet 4 min

**Rebel, François** (1701-1775) - **Francoeur, François** (1698 - 1787)

Suite II dall Opera Skanderbeg

Chaconne-Loure-Gay-Aria Splendete ,luci belle , Chaconne

---

\* Bis eventual fuori programma

**Rebel, François** (1701-1775) - **Francoeur, François** (1698 - 1787)

Suite II dall Opera Skanderbeg, Scittes air 3 min

# “ITALIANIZMI në barokun europian”

## LABORATORIO ARMONICO

Daniela Nuzzoli  
*Mezzosoprano dhe Violinë*

Gioannimaria Perrucci  
*Cembalo*



Duke udhëtuar në Itali nga 1706 në 1710 nga Firenze në Romë, nga Venezia në Napoli, G.F.Haendel mbeti i magjepsur nga arti italian i kantos: pasion, gëzim, mëshirë, çmenduri. Këto ndjesi dhe stili italian do të jenë “fil rouge” i të gjithë produksionit opertistik të tij dhe jo vetëm. Përmes kantatës, “Lucrezia” e shkruar për sopranon Margherita Durastanti, interpretuesja kryesore e “Agrippina”, ai do ti japë zë pasionit të heroinës romake, evokuar nga Tito Livio.

Haendel do ti dhurojë njerëzimit vepra të pakrahasueshme për nga bukuria në të gjithë fushat, si vokal ashtu dhe instrumental.

Paralelisht gjeniu i Leipzig J.S.Bach do të tërhiqet nga vitaliteti dhe kreativiteti i Vivaldit, i ashtuquajtur “prete rosso”, duke stjuar dhe përpunuar kompozime të ndryshme të tij.

Ky program i bazuar kryesisht në repertorin barok gjerman, evidenton sa stili dhe shija italiane ka influencuar oborret europiane të epokës. Bach, Haendel, përvetësojnë këtë stil e përpunojnë duke mbërritur majat më të larta. Kantoja amalgamohet me muzikën instrumentale duke e bërë vetë instrumentin, zë dhe kanto të një bukurie të shpërndarë në masë të barabartë.


Melodi me një shije italiane do të alternohen me fuga në stilin gjerman për të dy kompozitorët.

Një homazh i veçantë do ti kushtohet kompozitorit H.F.Biber me “Sonate del Rosario”, violinist i shkëlqyer student i Antonio Bertalit dhe J. H. Schmelzer e J.J. Walther; themelues të shkollës së violinës virtuoze gjermane.

---

Një nga vajzat e tij Anna Magdalena, këngëtare dhe violiniste do të ndjek hapat e babait, duke u bërë drejtuese e korit të Abacisë së Nonnberg.

Duhet thënë që deri në fund të tetëqindës ishte një kusht i domosdoshëm fakti që një muzikant të luante në më shumë se një instrument përveç së të këndonte, si psh. Maria Malibran dhe motra e saj Pauline Viardot ishin njëra violiniste e tjetra pianiste. Ky koncert është një okazion për të rizbuluar dhe vlerësuar një praktikë të së shkuarës, tashmë të harruar në ditët e sotme.



# Programi:

---

**Heinrich Ignaz Franz Biber (1644-1704)**

Nga Sonate del Rosario: Sonata n.1 në re minor për violinë dhe basso continuo *6' minuta*

**Antonio Vivaldi (1678-1741)**

Nga Giustino RV 717, aria e Anastasio "Vedrò con mio diletto" *5' minuta*

**Johann Sebastian Bach (1685-1750)**

Prelude, Fuga e Allegro BWV 998 në mi bemol maxhor për çembalo *11' minuta*

**Johann Sebastian Bach (1685-1750)**

Sonata HWV 1014 n. 1 në si minor për violinë e çembalo *14.30' minuta*

**Georg Friedrich Haendel (1685-1759)**

Pjesë nga Cantata HWV 145 "Lucrezia" për zë dhe basso continuo *8' minuta*

**Georg Friedrich Haendel (1685-1759)**

Affettuoso e Allegro nga Sonata HWV 371 op.

In. 13 në re maxhor për violinë dhe basso continuo

*6.30' minuta*

**Georg Friedrich Haendel (1685-1759)**

Nga Giulio Cesare, aria e Sesto: "Cara speme" *5.30' minuta*

Nga Giulio Cesare, aria e Cleopatra: "Da tempeste" për zë dhe çembalo

*6.30' minuta*



# Artistët

## **MATHILDE LEGRAND**

MEZZO-SOPRANO

(I Pizzicanti)



Mezzo-sopranoja franceze Mathilde Legrand ka studjuar në shkollën prestigjioze *Schola Cantorum Basiliensis* si dhe në opera studion e Zvicrës ku është diplomuar me vlerësim maksimal në 2015. Legrand ka interpretuar role si Ottavia dhe Amore (L'incoronazione di Poppea, Monteverdi), Adelberto (Ottone, Haendel), Musico (Viva la Mamma, Donizetti), Antonia (Man of la Mancha, Leigh), Lisetta (La Frascatana, Paisiello), Ramiro (Motezuma, Vivaldi). Repertori i saj recital përshin kompozitorë nga periudha baroke deri në kompozitorët romantik gjerman dhe italian. Ajo ka bashkëpunuar dhe me kompozitorë të rinj.

# Artistët

## ELOY ORZAIZ GALARZA

KLAVIÇEMBALIST

(I Pizzicanti)



Ai është një pianist, klaviçembalist dhe fortepianist i specializuar në performimin historik të repertorit të shekullit XVII-XVIII, si dhe gjysmës të shekullit XIX. Ai ka filluar studimet për piano në Spanjë, dhe më vonë i mbështetur nga qeveria spanjolle, u zhvendos në Hollandë për të studiuar piano, fortepiano e klaviçembalo në *Royal Conservatory of Hague* dhe *Conservatoire of Groningen*. Pas diplomimit *cum laude* në 2011, ai u zhvendos në Zvicër, për të hyrë në klasën e Jesper Christensen, Jörg Andreas Bötticher dhe Edoardo Torbianelli në *Schola Cantorum Basiliensis*. Eloy Orzaiz Galarza ka qënë pjesë e ansambleve më të njohur botëror si : *European Union Baroque Orchestra* dhe *Le Parlement de Musique*. Ai është i kërkuar për të luajtur me artistë të shquar si Linde Brunmayr Tutz , Johanette Zomer, Amandine Beyer, R. Minasi apo Paul Agnew. Momentalisht Orzaiz jep leksione klaviçembali pranë *CRR Saint-Maur-des-Fossés* dhe në *Hochschule für Musik und Darstellende Kunst Frankfurt* në Gjermani.



## KATIA VIEL

### VIOLINË BAROKE

(I Pizzicanti)



Pas studimeve të saj në konservatorin e Tuluzit Katia vazhdoi të perfeksionohej në *High School of Music of Geneva* regjistruar në klasën e Robert Zimansky dhe Patrick Genet për violinë ku njëkohësisht mori mësimë për violinën baroke me Florence Malgoire. Këto tre vite studimi u pasuruan dhe nga një shkëmbim Erasmus në Bruksel. Përgjatë këtyre viteve ajo ishte vazhdimisht e tërhequr nga muzika antike. Kjo bëri që ajo të vazhdonte një master për violinë baroke me Amandine Beyer në *Schola Cantorum Basiliensis*, ku ajo u ushtrua dhe në instrumentin e violës baroke.

Përgjatë studimeve të saj, Katia mori pjesë në shumë projekte muzikore me dirigjentë si : T. Koopman, H. Niquet, L. Garcia Alarcon, P. Herreweghe, K. Benzouidenhout, P. Agnew, M. Glodeanu.

Në tetor 2011, ajo mori pjesë në *Académie baroque européenne d'Ambronay* ku luajti Meshën në Si Minor të Bach dirigjuar nga S. Kuijken. Në 2012, ajo mori pjesë në *Academia Giovanile Montis Regalis* si violinë e parë nën dirigjimin e Enrico Onofri. Katia Viel punon për *La Cetra*, *Cappriccio Barockorchester*, *Freitagsakademie Bern Ensemble*, *Camerata Bern*, *Le Parlement de Musique*, *Cappella Murenensis*, *Geneva Camerata*, *La Chapelle Rhénane*, *Ensemble Elyma*, *Il Pomo d'Oro orchestra*, *Fratres Ensemble*, *Le Phénix orchestra*, *Novantik Ensemble*, *Montis Regalis orchestra*, *Ensemble baroque du Léman*, *Voce Suaves Ensemble*, *Teresia Youth Baroque Orchestra*.

Ajo është pjestare kryesore e *I Pizzicanti Ensemble* dhe *Abchordis Ensemble*, më të cilët ka regjistruar një CD me muzikë të shenjtë instrumentale napoletane të shekullit XVIII, publikuar nga shtëpia diskografike Deutsche Harmonia Mundi. Ajo ka regjistruar gjithashtu dhe me *I Profeti della Quinta*, *Kesselberg Ensemble* dhe *Camerata Rousseau* (S. Azzolini).

# Artistët

## FRANCESCO SPENDOLINI

CHALUMEAU

(I Pizzicanti)



I diplomuar për klarinetë moderne me vlerësim maksimal pranë konservatorit « G. Rossini » në Pesaro, në vazhdimësi nën udhëheqjen e G. Partisani dhe Luca Lucchetta, thellon studimet e tij drejt muzikës dhe instrumenteve të epokës, duke u diplomuar kështu për klarinetë antike pranë konservatorit « A. Pedrollo » të Vicenza-s me notë maksimale. Duke u perfeksionuar qoftë në repertorin si solist dhe orkestral me mjeshtra si Anthony Pay, (Accademia Chigiana di Siena), Thomas Friedly, (Accademia Perosi di Biella), Luca Lucchetta, Agide Brunelli, Guido Arbonelli, Sauro Berti, në 2010 transferohet në Zvicër për të thelluar studimet për instrumentët e epokës. Duke shkëlqyer në masterin për Spezialisierter Musikalischer Performance Alte Musik (SPAM – Master) pranë la Schola Cantorum Basiliensis me mjeshtrin Pierre-André Taillard, është diplomuar në vazhdim pas regjistrimit në një program master për interpretimin e muzikës së vonë romantike me instrumente antike sërish pranë Schola Cantorum Basiliensis, në të cilën mban dhe postin si Co-Leiter në kursin Harmoniemusik-Labor në bashkëpunim me Donna Agrell.

Ka performuar me orkestra të shquara si *l'Orchestra di Padova e del Veneto*, *Orchestra del Teatro Verdi di Trieste*, *Orchestra Regionale delle Marche*, *Les Musiciens du Louvre (Paris)*, *I Barocchisti (Lugano)*, *la Chambre Philharmonique (Paris)*, *Le Cercle de l'Harmonie (Paris)*, *il Complesso Barocco (Gjenevë)*, *la Cetra Baroque Orchestra (Bazel)*, *la Hofkappelle (Shtutgart)*, *Budapest Festival Orchestra*, *l'Ensemble Arcimboldo*, *Capriccio Bazel*, *Camerata Bern*, *Divino Sospiro (Lisbona)*, *l'Orchestra dell'Académie Baroque Européenne d'Ambronay*, *La Phoenix (Zyrih)*, *I Pizzicanti (Bazel)*, *Ensemble "Delfico"*, *New Century Baroque Orchestra (EU)*. Ka bashkëpunuar me dirigjentë si C. Hogwood, T. Koopman, A. Marcon, A. Florio, M. Minkoëski, E. Krivine, M. Gester, D. Fasolis, A. Curtis, L. G. Allarcòn, duke perfromuar në festivale prestigjioze në Gjermani, Francë, Zvicër, Spanjë, Turqi, Amerikë, Kore, Argjentinë etj. Ka regjistruar për Naïve, Gold& Lebert, Paragon, Delphin Alard, Radio France, France2, Arté, Radio Vaticana.

## JUSUF BESHIRI

CEMBALO

*(Albanian Baroque Ensemble)*



Jusuf Beshiri nis fillimet e studimeve ne piano në moshën 6 vjeç dhe në 1989 diplomohet në Istitutin e lartë të arteve (sot UART) me vleresimin maksimal të pikeve.

Ne 1991 transferohet në Milano duke filluar studimet në specialitetin “ Organo dhe kompozicion organistik” pranë Konservatorit Giuseppe Verdi – Milano. I përfundon studimet me vlerësimin maksimal ne vitin 1998. Pas përfundimit te ketyre studimeve frekuenton kurse perfeksionimi per repertorin organistik pranë prof. Michael Radulescu ne Liechtenstein , me Luigi Tagliavini dhe Jose Uriol pranë Akademisë së muzikës organistike në Pistoia. Ndërkohë bëhet pjesëmarres në shumë aktivitete artistike në mjaft qytete italiane si dhe jashtë saj, si Zvicër, Francë, Belgjikë, Slloveni, Shqipëri etj.

Ndërkohë fillon studimet pranë “ Accademia Internazionale della Musica” seksioni i muzikës antike -Milano për klavicembal në klasën e Laura Alvini, per ti perfunduar në Konservatorin e Milanos ne 2001 në specialitetin e instrumentave te vjeter si klavikordo, clavicembalo dhe fortepiano.

Vlerësimi maksimal në

diplomë dhe në këto instrumente bëri qe aktiviteti i tij artistik në itali të jetë tepër aktiv dhe i vleresuar nga kritika e kohes.

Ndërkohë fiton dhe konuksrin internacional të klavicembalit G:CAMBI në qytetin Pesaro (Itali).

# Artistët

---

Nga 2000-2011 bën pjesë në "UNITED EUROPE CHAMBER ORCHESTRA" si klavicembalist, organist dhe fortepianist duke zhvilluar një aktivitet të madh koncertal në repertorin barok dhe muzikes "sacra". Regjistron disqe per RCA, ITALIAN EASY MUSIC, VIDEO RHONA CLASIC.

Perveç pjesëmarrjes në këtë orkestër, është aktiv dhe në formacione të ndryshme të muzikës së dhomës duke bashkëpunuar me "Pomeriggi Musicali", orchestra "Guido Cantelli", Brianza Classica, "Festival Adriatico Mediterraneo" si dhe në Shqipëri si i ftuar nderi me "Mozaik", "Kamerata e Tiranës", "Festival internazionale NEI SUONI DEI LUOGHI" "Takimet muzikore të dy boteve", Stina koncertore në Universitetin e Arteve. Orkestra e Radiotelevizionit Shqiptar. Gjithashtu ka qenë organisti dhe klavicembalisti i parë i cili ka luajtur në inaugurimin e katedrales së Shen Palit ne Tiranë, i cili u organizua dhe me prezencen e Sekretarit te Vatikanit , Kardinal Sodano.

Eshte i ftuar i përvitshëm në festivalin internacional organistik " Città di Arezzo". Aktivitetit artistik i është bashkangjitur dhe ai didaktik. Ky i fundit fillon menjehere pas studimeve në Milano duke dhënë mësim si docent në "Accademia Internazionale della Musica" nga 2003-2010.

Eksperiencen e tij shume vjeçare në fushën e muzikës antike dhe baroke si dhe didaktike e sjell per herë të parë në Shqipëri me ftesë nga UART dhe mbeshtetje nga programi Brain Gain (UNDP) duke hapur për herë të parë katedrën e instrumentit të klavicembalit dhe muzikës baroke në vendin tonë. Aktualisht zhvillon aktivitetet koncertale dhe didaktike mes Italisë dhe vendit të lindjes. Pasioni për të shtrirë kulturën baroke në Shqipëri si dhe dëshira për të promovuara trashëgiminë kuluturore vendase e bëjnë që të ideoi dhe themeloi festivalin ndërkombëtar Vox Baroque, unik në llojin e tij, ku tingujt barok mund të vlerësohen brenda hapësirave të kishave , amifteatrove a rrënojave arkeologjike.

## PERIKLI PITE

CELLO & VIOLA DA GAMBA

(Albanian Baroque Ensemble)



Fillon studimin e muzikës në Liceun Artistik në Tiranë, dhe vazhdon në Akademinë e Lartë të Arteve, më pas transferohet në Itali dhe ndjek studimet për cello e viola da gamba në Konservatorin Arrigo Boito, Parma, me Robert Gini dhe në Konservatorin Gioacchino Rossini, Pesaro, Mo. Claudio Casadei me vlerësim maksimal e diplomë nderi. I vlerësuar me bursa studimi nga Shoqata të ndryshme: Fondazioni Gioacchino Rossini, Pesaro, 1997 .1999; "800 festival i Saludecio" 1998; Cecilia Ugolini Paci, III edizione, Pesaro, 1999; Fondazioni Giorgio Cini, Venezia, 2002. Me ensemble "Recitar Cantando"-2004, kanë fituar çmimin e parë në Konkursin e muzikës antike "D. Caravita" di Fusignano. Ka frekuentuar kurse specializimi në muzikë antike: Ishulli di S. Giorgio, Venezia 2002; Accademia "Franchino Gaffurio", Lodi; Ëieland Kujken, Mauro Valli. Bashkëpunon me: Kompleksin "Europa Galante" të Fabio Biondi, Jeanne Loriod solista në Onde Martenot, Luca Scandali, Alessandro Ciccolini, Gloria Banditelli, La Calandria, ensemble "Concerto" Roberto Gini, "Ensemble Cantar Lontano"; Ensemble "Terre d'Otranto"; I Barocchisti di Diego Fasolis, Canalgrande Adriatic Baroque Orchestra.

Është viololist i kompleksit "Europa Galante".

Aktiviteti është i shtrirë në shumë teatre: Praga a Teatro Stavovskem, Belfort Festival Francia, Università di Perugia, università Urbino, Auditorium Pedrotti di Pesaro, Réggia di Raconigi Torino, Lucerna (Svizera), festival Budva (Montenegro), festival internazionale Magie Barocche, Catania, Concertgebouw Amsterdam, Gulbenkian Grand Auditorium Lisbona, George Enescu Festival Bucarest, Konzerthaus Vienna, Opera de Montecarlo, Seoul Arts Center, Ayang Arts Center Daegu Korea, Opera-NCPA Pechino, Shanghai Oriental Arts Center Cina, Juliusz Soëacki Theatre, Karol Szymanoëski Philharmonic Hall, Cracovia, Ëarsaë Philharmonic, Concert Hall Ëarsaë Polonia, Festival Internazionale

# Artistët

---

Cervantino Guanajuato, Mexico, Auditorio Alfredo Kraus, Las Palmas De Gran Canarias, Palau de la Mùsica Valencia Spagna, Auditorium Sinopoli Parco della Musica, Roma, Conservatoir de Bruxelles, Belgio, Mozart Festival Èürzburg, Germania, Grand Théâtre de Provence Aix en Provence, Grand Théâtre de Caen Francia, Cattedrale di Bodø, Konserthuset STAVANGER Norvegia, Albert Hall, Èigmore Hall London. Barbican Centre Hall London, Kangaëa Kenritsu Ongakudo -Yokohama, Tokyo Opera City, Matsumoto Harmony Hall Japan, Concert hall- The Hong Kong Academy for Performing Arts-Hong Kong.

Ka regjistruar disqe për: Clavis, Brillant, Bongiovani Bologna, Tactus, EMI/Virgin , Glossa. Èshtë docent violonçeli në Liceun e Muzikës G.Marconi në Pesaro. dhe viola da gamba ne AMMA -Akademie Marchigiana te Muzikës Antike ne Pesaro .



## KLODIANA BABO

VIOLINË BAROKE

(Albanian Baroque Ensemble)



Filloi studimet e violinës në moshën 6 vjeçare, në shkollën Art. J. Misja në Tiranë. Koncertet dhe aktivizimet fillojnë që e vogël me konkurse për fëmijë, koncerte për grupe harqesh dhe regjistrime në radio-televizionin Shqiptar. Diplomohet me vlerësim maksimal në violinë në moshën 18 vjeçare. Frekuentoi vitet e para të Akademisë së Arteve në Tiranë dhe më pas u zhvendos për të vazhduar studimet në Konservatorin G. Rossini në Pesaro. Diplomohet me nderimet më të larta e “Lode”.

Eshtë specializuar në studime filologjike dhe doktoraturë në “violino barocco” në Konservatorin B. Maderna në Cesena, me M<sup>o</sup> Luca Giardini, ku u diplomua me notë maksimale cum “Lode” e “Menzione speciale”. Ka ndjekur masterklase dhe kurse të mbajtur nga muzikantë të njohur si; Alessandro Ciccolini, Enrico Onofri, Susanne Scholz, Doron Sherwin, etj.. Ka bashkëpunuar me ansamble të shumta si; Ensemble barok “La Calandria”, “Adriatic Baroque Orchestra”, “I Virtuosi Italiani”, “L’Orchestra Barocca di Bologna”, “Auser Musici”, Ensemble “La Sprezzatura” etj.. Ka luajtur nën drejtimin e mjeshtrave të njohur si; Marco Mencoboni, Paolo Faldi, Michele Vannelli, Corrado Rovaris, Alessandro Ciccolini, Sergio Balestracci etj . Ka marrë pjesë në festivale prestigjioze dhe skena të tilla si; Chiesa della Pietà, Scola San Rocco dhe teatro La Fenice (në Venecia), festival Galuppi, Camerino Festival, ne Bazilikën e San Petronio në Bolonjë, festival Pergolesi, festival Cantar Lontano, festival “Opera Barga”, në teatro të ndryshme italiane etj.. E apasionuar me didaktiken e instrumentit i ka kushtuar vite studimit te mësimdhënjes së violines.

Ka regjistruar për shtëpi diskografike prestigjioze; Glossa, Tactus, Clavis, apo E Lucean le Stelle.

# Artistët

## DAORSA DERVISHI

FLAUT TRAVERSIER BAROK

(Albanian Baroque Ensemble)



Fillon studimet e flautit në Shkollën e Mesme Artistike "Jan Kukuzeli" Durrës dhe, nën udhëheqjen e mësueses Athinula Çaprazi, diplomohet me notë maksimale.

Në vitin 2000 vijon studimet pranë Konservatorit "G. Verdi", Milano, Itali. Pasi diplomohet për flaut modern, ndjek dhe përfundon me rezultate të larta edhe dy vjeçarin për Diplomën e Nivelit të Dytë Akademik, me M<sup>o</sup> G. Gallotta dhe M<sup>o</sup> G. Cambursano. Paralelisht, në të njëjtin Konservator, fillon studimet e flautit traversier barok me M<sup>o</sup> G. B. Columbro dhe në shkurt të 2010 diplomohet me 10 Cum Laude.

Pas studimeve, ndjek kurse perfeksionimi dhe master classes me profesorët e mirënjohur si: J.C.

Gerard, D. Formisano, B. Grossi, C. Santambrogio, B. Kuijken e M. Gatti.

Kryen aktivitetin e saj koncertor si soliste ashtu edhe me grupe dhome të ndryshëm duke përdorur instrumentet e periudhës baroke, klasike dhe moderne.

Luan në Institute prestigjioze si: Akademia e Arteve Brera në Milano, Akademia e Arteve në Tiranë, Teatri A. Moisu në Durrës, Teatri Fraschini në Pavia, Salla Puçini në Konservatorin e Milanos,

Bazilika San Marco në Milano, Muzeu i Kremonës, Instituti Peri në Rexho Emilia, Tribuna e Davidit të Mikelanxhelos në Firenze, Teatri Alaleona në Montexhorxho, Salla e Koncerteve e Konservatorit Nicolini në Piacenza, etj,...

Veç të tjerash, luan për Festivalin Lodoviciano të Viadanës si në rolin e solistes ashtu edhe në rolin e flautit të parë të orkestrës së Festivalit dhe në stinët koncertore:

"Concerti nel Chiostro" në Milano, "Ricerca D'Ascolto" në Kremona, "DanzaParco" në Bresha, në edizionin e XXXVII-të "Stagione Musicale della Canonica di Brezzo di Bredero", Bibiena Art Festival në Piacenza edicioni 2010 dhe 2015, "Note dipinte" në Novara, Note Barocche në Valle Scrivia, Netët e Muzikës Klasike në Durrës, Festivali i Muzikës në Crema, Festivali i Muzikës Antike "Suoni d'Arte" në Xhenova, etj,...

Në vjeshtën e vitit 2014 merr pjesë si soliste në turneun e grupit "I Solisti Laudensi" që u



---

zhvillua në Italinë veriore dhe atë qendrore.

Me grupin Italian "Classical Consort" regjistron për etiketën zvicerane Gallo pjesë të muzikës së dhomës nga Gioachino Rossini me instrumente të periudhës, ku njëra nga pjesët është regjistrimi i parë botëror. Në 2007 merr pjesë në aktivitetin "Compositori a Confronto" pranë Institutit Peri të Rexhio Emillas ku luan tre pjesë bashkëkohore të përfshira në përmbledhjen diskografike me të njëjtin emër. Në prill të 2012 luan në CD-në e etiketës Sheva Collection kushtuar kompozitorit kremonez Oreste Riva, në pjesën Epinicion, regjistrim i parë botëror.

Në 2010 bashkëpunon me Universitetin e Arteve të Bukura në Tiranë si Visiting Professor nga projekti Brain and Gain për degën Repertori Barok i Flautit. Aktualisht, bashkëpunon si flautiste baroke në koncertet dhe aktivitetet e Konservatorit "G. Nicolini" të Pjaçencës.

Është bashkëthemeluese e grupit AlbanianBaroqueEnsemble, grupi i parë muzikor barok shqipëtar.

Ky grup u themelua në verë të 2014 me rastin e festivalit të parë të muzikës baroke në Shqipëri, Vox Baroque.



# Artistët

## GIOVANNIMARIA PERRUCCI

CEMBALO

(Laboratorio Armonico)



Giovannimaria Perrucci ka përfunduar studimet për organo dhe klaviçembalo pranë Konservatorit “G. Rossini” në Pesaro. Më pas është perfeksionuar në Francë pranë, “Conservatoire National Supérieur” të Lionit.

Zhvillon aktivitetin koncertal qoftë si solist ashtu dhe në bashkëpunim me ansamblet më të rëndësishme duke u bërë pjesë e festivaleve më prestigjioze në Europë dhe Japoni. Ka realizuar regjistrime radiofonike për RAI, Radio Montebeni dhe për Hessischer Rundfunk, Frankfurt ndërkohë që nuk kanë munguar regjistrime pranë shtëpive diskografike “Discantica”, “Bongiovanni”, “Tactus” dhe “Opera Tres”. Ka publikuar për “Ut Orpheus” në Bolonja edicionin modern të veprave për tastierë të Francesco Basilj. Së fundmi ka ndjekur si konsulent regjistrimin e “Cantate da camera” të Pietro Porfiri – autor i rëndësishëm i shekullit XVII përmes shtëpisë diskografike “Tactus” duke realizuar kështu një CD me muzikë të panjohur për vokal dhe organo në bashkëpunim me Daniela Nuzzoli.

Duke qënë i ndjeshëm ndaj trashëgimisë organistike, ka marrë pjesë në inventarizimin e organove historike për rajonin Marche.

Është autor i teksteve sa i takon trashëgimisë organiste të rajonit Marche, mes tyre dhe regjistrin e organove historike për Dioqezën e Fanos në Macerata, si dhe shumë artikuj për Fondacionin “Cassa di Risparmio di Fano”. Në rolin e ekspertit dhe konsulentit për Dioqezën e Fanos, ka ndjekur gjithashtu dhe restaurimin e shumë organove historike. Është drejtor artistik i “Concerti d’organo” i kishës Santa Maria Nuova në Fano, që sot numëron 55 edicione. Jep leksione pranë liceut muzikor shtetëror të Pesaros dhe Istituto diocesano di Musica sacra në Fano.

## DANIELA NUZZOLI

MEZZO-SOPRANO E VIOLINISTA

(Laboratorio Armonico)



E lindur në Senigallia (Ancona), ajo diplomohet shkëlqyeshëm për violinë, kanto dhe muzikë vokale dhome në konservatorin e Veronës dhe Mantovës.

Dubuton ne Radio France (Paris) në operën e Puccini:

"Iphigénie en Tauride" shoqëruar nga Orchestre National de France, nën drejtimin e Enrique Mazzola, me një kast brilant si Luca Pisaroni e Gregory Kunde. Ka interpretuar rolin e "Donna Elvira" në operën "Don Giovanni" të Mozart në Teatro delle Erbe, Milano, nën drejtimin e Charles Olivieri-Munroe. Sa i takon repertorit koncertal Nuzzoli ka marrë pjesë në festivale të rëndësishme ndërkombëtare në Spanjë, Francë, Amerikë.

Është shpesh prezente në "Festival of Opera & Arts" në Palm Desert dhe "Opera under the stars" në Palm Spring, Kaliforni (SHBA). Ka kënduar si contralto në "Requiem"-in e Mozart me Redlands Symphony Orchestra në Kaliforni, për sezonin koncertal të ECC "El Camino" në Los Angeles si dhe ka realizuar recitale të shumtë në Francë me "Orchestre de Chambre" të Toulus-it (Francë) nën drejtimin e maestro Gilles Colliard. Përmes shtëpisë diskografike Tactus në 2013 ka publikuar si premierë botërore CD me Offertori të Giuseppe Giordani për vokal dhe organo si dhe në 2015 CD me kompozime dhome për vokal dhe pianoforte të Giuseppe Verdit.

Sa i takon karrierës së saj si violiniste ajo ka debutuar si soliste me Koncertin për violinë dhe orkestër të Samuel Barber në Teatro Filarmonico të Veronas nën udhëheqjen e maestro Enrique Mazzola.

Duke u apasionuar pas muzikës baroke ajo ka bashkëpunuar me grupet me të njohura ndërkombëtare që lëvrojnë këtë muzikë si, Giardino Armonico, Europa Galante, Accademia Bizantina, Talents Lyriques, Concert d'Astrée, etj.

Në aktivitetin e saj muzikor ka bashkëpunuar me artistë të shquar si Cecilia Bartoli, Joyce Di Donato, motrat Labeque, Giovanni Antonini, Fabio Biondi, Christophe Rousset etj. Ka performuar në skena si : Oji Hall (Tokyo), Carnegie Hall (New York), Sidney Opera House (Sidney), Barbican (London), Ëgmore Hall (London), Lincoln Center (New York), Théâtre de Champs-Élysée (Paris), Salle Gaveau (Paris).

Ka regjistruar për shtëpi diskografike si: Decca, Naïve, Emi-Virgin, Sony.

Zhvillon aktivitetin e saj koncertal dhe solistik si në violinë ashtu dhe në kanto.

# Artistët

## GIANGIACOMO PINARDI

TIORBA

(I ftuar)



Giangiaco Pinardi është specializuar në studimin e instrumenteve me Massimo Lonardi pranë *Istituto Musicale "F. Vittadini"* të Pavis dhe në vazhdim ka ndjekur kurset vjetore të *Scuola di Musica Antica* në Venezia. Si solist dhe shoqërues ka bashkëpunuar me formacione të shumta të specializuara në repertorin rilindas dhe barok (I Barocchisti, Zefiro, Balthasar Neumann Ensemble, I Solisti Veneti, Alessandro Stradella Consort, Accademia San Felice, Arte Resoluta, Curtes Francae, Fantazyas, Odhecaton). Me një aktivitet tejet të ngjeshur koncertal në Itali dhe jashtë që prej 2001 ai bashkëpunon vazhdimisht me ansamblin *Europa Galante* drejtuar nga Biondi, me të cilin performon rregullisht ne sezonet më të rëndësishme koncertale dhe operistike ndërkombëtare si: Carnegie Hall, Lincoln Center dhe Miller Theatre në New York, Teatro alla Scala di Milano, Auditorium di Santa Cecilia në Roma, Teatro Massimo di Palermo, Teatro La Fenice di Venezia, Concertgebouw Amsterdam, Théâtre des Champs Eliseés, Théâtre de la Ville, Salle Gaveau, Salle Pleyel e Cité de la Musique në Paris, Barbican Center në Londër, Gulbenkian në Lisbona, Filarmonica në Varshavë, Disney Hall në Los Angeles, Library of Congress në Washington, Tokyo Opera City Concert Hall, Sydney Opera House) në të gjithë Europën SHBA, Amerikën e Jugut, Kinë, Kore, Hong-Kong, Japoni, Australi, Zelanda e Re.

Ka mbi 60 regjistrime me shtëpi diskografike si: Emi-Virgin, Sony-Deutsche Armonia Mundi, Opus 111, Chandos, Amadeus, Tactus, Dynamic, Bongiovanni, Stradivarius, Orfeo, ASV Record, Claves, dhe për emitente radio-televizive europiane dhe amerikane. Ka bashkëpunuar si shoqëruese për orkestër e Teatro La Fenice di Venezia, l'Orchestre de Chambre de Lausanne, orkestra I Solisti di Perugia, orkestra del Teatro Comunale di Bologna, orkestra Pro Arte Marche, orkestra Guido Cantelli dhe Orquesta de la Comunidad de Madrid. Nga 2007 bashkëpunon rregullisht me Stavanger Symfoniorkester (Norvegji). Ka kuruar edicionin kritik të veprës "Varii Capriccii per la Ghittara Spagnuola" (Milano 1643) e F. Corbetta.

## MIHO KAMIYA

SOPRANO

(E ftuar)



E diplomuar në kanto pranë l'Università Statale di Belle Arti e Musica në Tokyo, ajo ka zhvilluar doktoraturën për kanto baroke. Ka studiuar për muzikë mesjetare me Rebecca Stewart në Hollandë dhe është diplomuar për kanto baroke me Cristina Miatello pranë Conservatorio Dall'Abaco në Verona. Ka studiuar kanto baroke e rilindase me Gloria Banditelli pranë konservatorit "G.B. Martini" të Bolonjës, duke u diplomuar me vlerësimin maksimal, dhe nderime të veçanta. Ka marrë pjesë në shume masterklase për lëvrimin e muzikës baroke me figura të shquara si Max van Egmond, Gloria Banditelli, Roberta Invernizzi, Sonia Prina dhe Fabio Bonizzoni.

Ka fituar çmimin e dytë në "Concorso dell'Associazione della Musica Classica" në Tokio dhe është kualifikuar në seleksionimin special për "Debut Concert for Young Artists" në Tokio Bunka Kaikan.

Ka qënë finaliste në shumë konkurse si dhe ka fituar një bursë studimi nga fondacioni Nomura Cultural Foundation në Tokio për tu specializuar në muzikë rilindase dhe baroke në Itali.

Pas debutimit në Tokio me L'Incoronazione di Poppea të Monteverdi-t nën drejtimin e Masaaki Suzuki,

ajo ka marrë pjesë në shumë sfaqje operistike si Dido and Aeneas të Purcell, Orphée aux Enfers të Offenbach, The Old Maid and the Thief të Menotti, Happy end të Kurt Weill dhe në koncerte me muzikë dhome (Magnificat dhe kantatat e Bach, Membra Jesu nostri të Buxtehude, Gloria të Vivaldi etj).


Ka bashkëpunuar me shumë ansamble si dhe ka kënduar për herë të parë në histori muzikë të kompozitores kontemporane Chiara Benati.

E vendosur në Itali ajo ka bashkëpunuar me muzikantë të njohur si Silvia Rambaldi e Gloria Banditelli, me muzikologë si Luigi Ferdinando Tagliavini, Elio Durante dhe Anna

---

Martellotti. Ajo është pjesë e ansambleve si “Armonia delle sfere” nga Daniele Salvatore, dhe e “Concerto segreto” përmes të cilëve ajo ka marrë pjesë në programe me muzikë baroke dhe rilindase në qytete të ndryshme në Itali, duke marrë pjesë në festivale të rëndësishme. Gjithashtu ajo është e dedikuar në shpërhapjen e kulturës muzikore japoneze përmes koncerteve dhe regjistrimeve diskografike . Ka qënë pjesë e projektit për regjistrimin e CD-së “Madrigali për Laura Peperara” për Tactus me muzikë nga Luzzaschi, Virchi dhe Agostini për canto dhe klaviçembalo si dhe për të njëjtën shtëpi ka regjistruar CD-në “Frescobaldi-Arie musicali” dhe “Produzioni Armoniche” të Antonia Bembo, ku ka kuruar transkriptimin modern.

Është përgjegjëse për kërkimin muzikor pranë Associazione Culturale Bal'danza të Ferrara.



# Stafi

---

*Drejtor i Festivalit*  
**JUSUF BESHIRI**

*Drejtor i Qendrës Vox Baroque*  
**DENIZ BESHIRI**

*Drejtori Artistik*  
**PERIKLI PITE, JUSUF BESHIRI**

*Manaxher i përgjithshëm i Festivalit Vox Baroque*  
**BESMIR VOKOPOLA**

*Kurator Imazhi*  
**ELIDJON GREMBI**

*Dizajner Grafik*  
**FLORIAN BREGU**

*Fotograf*  
**ILIR ZAHAJ**

---

---

---

